

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# TAKSA E KARBONIT

MUNDËSI PËR MJEDIS  
JETËSOR MË TË  
SHËNDETSHËM PËR  
QYTETARËT

  
TOGETHER IN  
**CLIMATE  
ACTION**

# TAKSA E

# KARBONIT

MUNDËSI PËR MJEDIS  
JETËSOR MË TË  
SHËNDETSHËM PËR  
QYTETARËT

## Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

## Autore

Bojana Bozhinovska Siljanovska

## Projekti

Organizatata civile në veprim për ndryshimet klimatike

## Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor “Eko-svest” nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

## Redaktimi gjuhësor

Eleonora Stojkoska –Popetrevska

## Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi

Rexhep Xheladini

## Dizajn grafik

Haris Muriq

## Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit “Organizatata civile në veprim për klimën”, mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

REZYME	1
HYRJE	2
METODOLOGJIA	2
KORNIZA LIGJORE	3
KAPACITETET INSTITUCIONALE	3
LIGJI PËR VEPRIMIN KLIMATIK	5
TAKSA E KARBONIT	6
KOMENTE PËR LIGJIN PËR VEPRIMIN KLIMATIK	7
REKOMANDIME	10
LITERATURA E PËRDORUR	11

# PËRMBAJTJA

# REZYME

Korniza ekzistuese ligjore dhe institucionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ofron të gjitha kushtet e nevojshme për zbatimin dhe monitorimin efikas dhe efektiv të masave dhe politikave të miratuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe është e nevojshme të ndërmerren veprime në nivel nacional dhe lokal për kapërcim të situatës. Ligji për Veprimin Klimatik do të krijojë një kornizë për veprimin klimatik për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë në atmosferë dhe për largimin përmes absorbuesve natyrorë dhe të tjerë, si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Është e nevojshme të sigurohen përgjegjësitë e institucioneve në veprimet klimatike me personelin e nevojshëm, të kualifikuar dhe për aq sa është e mundur, të ketë strukturë të veçantë për veprimin klimatik, qoftë sektor apo departament.

Ligji për Veprimin Klimatik parashikon taksën e karbonit, që do të thotë se personat juridikë që kryejnë një veprimtari, gjegjësisht një aktivitet dhe që emetojnë gazra serrë gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, janë të detyruar të paguajnë taksën për emetimin e gazrave serrë për çdo ton dyoksid karboni të emetuar të verifikuar ose ekuivalent të dyoksidit të karbonit.

**Vendosja e taksës së karbonit mund të përfaqësojë mundësi për shpenzim të dedikuar të parave dhe përmirësim të mjedisit jetësor për qytetarët.**

# HYRJE

Vlerësohet se që nga periudha para-industriale, aktivitetet njerëzore kanë rritur temperaturën mesatare globale të Tokës me 1,8 gradë Celsius, një numër që aktualisht po rritet me 0,36 gradë Celsius çdo dekadë. Trendi aktual i ngrohjes është padyshim rezultat i aktivitetit njerëzor që nga vitet 1950-ta dhe po ndodh me një ritëm të paprecedentë gjatë mijëvjeçarëve.<sup>1</sup>

Si një sfidë globale, ndryshimet klimatike kërkojnë veprim urgjent nga të gjitha vendet. Duke njohur kërcënimin dhe nevojën për të ndërmarrë veprime kundër ngrohjes globale, vendet bëjnë një përpjekje të përbashkët për të luftuar ndryshimet klimatike në përputhje me kërkesat e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (në tekstin e mëtejshëm: Konventa). Republika e Maqedonisë së Veriut është e përfshirë në mënyrë aktive në përpjekjet globale për të luftuar efektet negative të ndryshimeve klimatike.

Si një vend me rreth 2 milionë banorë, Republika e Maqedonisë së Veriut përbën një pjesë të vogël të emetimeve të gazrave serrë në nivel global. Megjithatë, vendi ka emetime të larta të dyoksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) për kokë banori dhe vazhdimisht përballet me cilësi të dobët të ajrit dhe forma të tjera të ndotjes së mjedisit jetësor të shkaktuar nga djegia e lëndëve djegëse fosile, aktivitetet industriale, menaxhimi joadekuat i mbetjeve dhe praktikat e paqëndrueshme të menaxhimit bujqësor dhe pyjor. Republika e Maqedonisë së Veriut e ka pranuar nevojën për të ndërmarrë veprime efektive për të zbutur ndikimet negative të ndryshimeve klimatike. Në këtë drejtim, vendi ratifikoi Konventën më 4 dhjetor 1997 dhe u bë anëtar i Konventës më 28 prill 1998.<sup>2</sup>

## METODOLOGJIA

Punimi synon të arrijë objektivat e mëposhtme kërkimore:

- **Prezantim të Ligjit për Veprimin Klimatik;**
- **Informimi për zbatueshmërinë dhe komentimin e Ligjit;**
- **Dhënie të rekomandimeve.**

Qasja metodologjike në përgatitjen e dokumentit përfshin zbatimin e metodave të mëposhtme të kërkimit:

- **Hulumtim nga zyra – konsultim të ligjeve përkatëse nacionale, raporteve dhe dokumenteve.**

<sup>1</sup> <https://climate.nasa.gov/global-warming-vs-climate-change/#:~:text=Global%20warming%20is%20the%20long,gas%20levels%20in%20Earth's%20atmosphere.>

<sup>2</sup> Raport për vlerësimin e ndikimit të rregullores - Ligji për veprimin klimatik, i publikuar në Regjistrin e unifikuar kombëtar të rregullores të Republikës së Maqedonisë së Veriut [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=77486](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=77486)

# KORNIZA LIGJORE

Ligji për Mjedisin Jetësor deri më tani është i vetmi ligj që përmban dispozita përkatëse për temën e ndryshimeve klimatike dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka përpiluar:

1. **Tre raporte nacionale (komunikata) për Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike 2003, 2008 dhe 2014;**
2. **Tre raporte dyvjeçare mbi ndryshimet klimatike - 2015, 2018, 2021;**
3. **Parashtrimi fillestar dhe i përforcuar nacional ndaj Marrëveshjes së Parisit, 2018, 2021;**
4. **Strategjia afatgjate dhe Plan veprimi për veprimin klimatik, 2021;**
5. **Katër plane nacionale për ndryshimet klimatike.**

Republika e Maqedonisë së Veriut deri më tani ka ratifikuar këto dokumente ndërkombëtare:

- › **Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike,**
- › **Marrëveshjen e Kiotos,**
- › **Amendamentin e Dohas,**
- › **Amendamentin Kigali dhe**
- › **Marrëveshjen e Parisit.**

Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), me qëllim të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me ligjin e BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike dhe përmbushjes së detyrimeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike ndaj detyrimeve të BE-së, është përgatitur Projektligji për Veprimin Klimatik.

# KAPACITETET INSTITUCIONALE

Korniza ekzistuese ligjore dhe institucionale në Maqedoninë e Veriut nuk ofron të gjitha kushtet e nevojshme për zbatimin dhe monitorimin efikas dhe efektiv të masave dhe politikave të miratuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe është e nevojshme të ndërmerren veprime në nivel nacional dhe lokal për t'u tejkaluar situata. Me angazhimin dhe përpjekjet e investuara të institucioneve shtetërore janë pranuar detyrimet ndërkombëtare për uljen e efektit të ndryshimeve klimatike, ndërkohë që janë përgatitur

dhe miratuar një numër i madh dokumentesh strategjike, planifikuese dhe programore në nivel nacional dhe lokal. Aktivitetet e përcaktuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike në dokumentet e përmendura nuk janë zbatuar plotësisht dhe nuk monitorohet realizimi i tyre.

Komisioni Nacional për Ndryshimet Klimatike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili duhet të ofrojë udhëzime për veprimet e përgjithshme klimatike, si dhe të kontribuojë në integrimin e aktiviteteve në politikat, planet dhe masat sektoriale, është themeluar në vitin 2003, por në praktikë nuk e bën këtë funksion, pra ekzistenca e tij është e natyrës formale.

Nuk është krijuar asnjë sistem për inventarizimin e emetimeve të gazrave serrë, ndërkohë që nga disa institucione është krijuar një Inventar Nacional i emetimeve të gazeve serrë. Prandaj, nuk ka një bazë të dhënash të vetme të emetimeve të gazrave serrë në një vend, gjë që e bën të vështirë përdorimin e tyre në përgatitjen e dokumenteve nacionale strategjike, planifikuese dhe programore për veprimin klimatik.

Mungon lidhja dhe koordinimi funksional ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe vendor në zbatimin e masave dhe aktiviteteve për planifikimin e politikave zbutëse të ndryshimeve klimatike, si dhe monitorimin e tyre. Mungesa e burimeve financiare, personelit dhe teknike, si një parakusht thelbësor për integrimin e politikave klimatike në të gjithë sektorët, kontribuon më tej në mos arritjen e efekteve të dëshiruara për zbutjen e ndryshimeve klimatike.<sup>3</sup>

Enti Shtetëror i Revizionit bën me dije se ka burime të kufizuara njerëzore dhe teknike për ndryshimet klimatike pranë institucioneve kompetente, gjë që ndikon në funksionimin efikas të tyre. Edhe pse disa aktivitete janë nisur për të forcuar kapacitetet e personelit për menaxhimin e ndryshimeve klimatike, ekziston ende nevoja për t'i përshpejtuar ato duke organizuar trajnime për punonjësit, aktivitetet e punës së të cilëve lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e veprimit klimatik. Nevojitet një analizë e trajnimeve të kryera tashmë për të krijuar një pasqyrë fillestare të gatishmërisë së institucioneve për t'u përballur me sfidat e veprimit klimatik, të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore.

Ka mungesë të platformave softuerike funksionale për monitorimin dhe verifikimin e efikasitetit të energjisë dhe emetimeve të CO<sub>2</sub>, gjë që e bën të pamundur monitorimin e rezultateve të aktiviteteve të ndërmarra për të arritur kursime më të mira të energjisë dhe emetim më të ulët të gazeve serrë, të cilat duhet të jenë bazë për planifikimin e masave të ardhshme dhe aktivitetet e veprimit klimatik.<sup>4</sup>

Në Maqedoninë e Veriut, përcaktimi i buxhetit për klimën nuk është realizuar dhe mungon një sistem monitorimi për shpenzimet publike të destinuara për zbutjen/për-

<sup>3</sup> Raporti përfundimtar i auditimit të performancës "Masat dhe politikat e marra nga RMV-ja/autoritetet kompetente për të zbutur ndryshimet klimatike", maj, 2022  
[https://dzt.mk/sites/default/files/2022-07/68\\_RU\\_Prezemimi\\_merki\\_politiki\\_UBLAZUVANJE\\_KLIMATSKI\\_PROMENI\\_KOMPLET\\_2022.pdf](https://dzt.mk/sites/default/files/2022-07/68_RU_Prezemimi_merki_politiki_UBLAZUVANJE_KLIMATSKI_PROMENI_KOMPLET_2022.pdf)

<sup>4</sup> Ibid

shtatjen e ndryshimeve klimatike. Mungesa e kriterëve dhe i një përcaktimi të qartë të financimit klimaterik në legjislacion ishte një nga temat që revizioni/auditimi e trajtoi duke analizuar një dokument të titulluar "Kriteret për përcaktimin e programeve/projekteve dhe aktiviteteve të lidhura me ndryshimet klimatike" të përgatitur nga UNDP-ja. I njëjti dokument thekson rëndësinë e përcaktimit të buxhetit për klimën në mënyrë që të motivojë realizuesit e buxhetit që të formësojnë më mirë sistemet e tyre të menaxhimit të financave publike dhe të përfshijnë në politikat nacionale klimaterike si pjesë e procesit buxhetor. Buxheti i Maqedonisë së Veriut nuk njeht përcaktim buxhetor për ndryshimet klimatike, por duke pasur parasysh se një nga prioritetet strategjike gjatë krijimit të Buxhetit është mbrojtja e mjedisit jetësor, zhvillimi i gjelbër, reduktimi i ndotjes së ajrit dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike, auditimi beson se është e nevojshme të ndërmerren masa nga institucionet kompetente për shqyrtimin e këtyre aspekteve.

## LIGJI PËR VEPRIMIN KLIMATIK

Në dhjetor 2022, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e publikoi **Projektligjin për Veprimin Klimatik**<sup>5</sup> në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional. Projektligji për Veprimin Klimatik është në përputhje me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian që rregullojnë veprimin klimatik të shteteve anëtare dhe planifikohet të krijohet një kornizë për veprimin klimatik për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë në atmosferë dhe largimin përmes natyrës dhe absorbuesve të tjerë, si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Ligji, në fakt, parashikon të ashtuquajturat Korniza për Veprim Klimatik, i cili përfshin planifikimin për veprimin klimatik dhe harmonizimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese nga sektorët e tjerë me dokumentet bazë të planifikimit për veprimin klimatik, duke krijuar një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazrave serrë dhe largimin nga absorbuesit, duke përfshirë Inventarin Nacional dhe sistemin e raportimit për politikën, masat dhe projeksionet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji, kushtet për dhënien e lejeve për emetimet e gazrave serrë për operatorët e instalimeve të palëvizshme, monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazrave serrë nga aktivitetet e aviacionit dhe masat për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë në sektorë të caktuar dhe përshtatja e sektorëve ndaj ndryshimeve klimatike.

Prandaj, është e qartë se me këtë akt ligjor, Republika e Maqedonisë së Veriut synon të krijojë një qasje strategjike për ndërmarrjen e veprimeve klimatike me qëllim të zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes ndaj efekteve të padëshiruara të ndryshimeve klimatike, duke ndjekur detyrimet dhe rekomandimet që dalin nga dokumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për reduktimin e gazrave serrë. Në këtë drejtim, ligji parashikon miratimin e një Strategjie Afatgjate për Veprim Klimatik dhe Plan Veprimin për Klimën, si dhe një Plan Nacional për Energjinë dhe Klimën.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=77486](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=77486)

<sup>6</sup> Анализа за развојот и одржливото планирање на транспортот во Република Северна Македонија од аспект на влијанието врз климатските промени, МЗМП, Скопје 2023



Në pjesën e dhënies së drejtimeve, mendimeve dhe rekomandimeve për veprimet e përgjithshme klimatike si pjesë e veprimit klimatik për integrimin e veprimeve klimatike në politikat sektoriale, ligji parashikon edhe ngritjen e një Mekanizmi Nacional Koordinues për Veprimin Klimatik, i cili përbëhet nga Këshilli Koordinues për Veprimin Klimatik, Këshilli Nacional i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Trupi Këshillimor Shkencor. Në kuadër të Mekanizmit Nacional Koordinues për Veprimin Klimatik, hyjnë të gjithë aktorët përkatës nga organet e administratës, shkenca, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e qytetarëve, për të siguruar koordinimin e plotë të kapaciteteve për veprim klimatik.

## TAKSA E KARBONIT

Ligji për Veprimin Klimatik vendos taksën e karbonit, e cila nënkupton që personat juridikë që kryejnë një veprimtari, gjegjësisht një aktivitet dhe emetojnë gazra serrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, janë të detyruar të paguajnë taksë për emetimin e gazrave serrë për çdo ton të dyoksidit të karbonit të emetuar të verifikuar ose ekuivalenti i dyoksidit të karbonit.

Ligji përcakton se taksa e karbonit do të jetë me rritje graduale, duke filluar nga jo më pak se 2,5% e shumës së çmimit të tregut të emetimeve të lejuara në tregun e rregulluar evropian.

Është veçanërisht e rëndësishme që ky nen dhe kapitull i ligjit të përcaktojë fondet nga taksa e karbonit si të dedikuar dhe të përcaktojë se për çfarë do të përdoren ato. Mjetet e mbledhura nga taksa janë të hyra të buxhetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe përdoren ekskluzivisht për financimin dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në ligj, aktivitetet për investime miqësore ndaj klimës, për edukimin në fushën e ndryshimeve klimatike, për informim dhe ndërgjegjësim publik dhe për aspektet gjinore, të rinjtë dhe grupet vulnerabile (të cenueshme), etj.<sup>7</sup>

Mjetet e grumbulluara do të shpërndahen sipas programit vjetor për financimin e aktiviteteve të veprimit klimatik, i cili propozohet nga Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bazë të aktiviteteve të parapara në dokumentet planifikuese.

Është e rëndësishme të ruhet ky formulim gjatë miratimit të ligjit, në mënyrë që shteti të ketë një mekanizëm real për zbatimin e zotimeve të marra me ligj, si dhe për realizimin e detyrimeve të marra me dokumentet ndërkombëtare. Përndryshe, ndarja e papërcaktuar e fondeve nuk do të kontribuojë realisht në qëllimin përfundimtar të ligjit, gjegjësisht në veprimin për klimën.

<sup>7</sup> Draft-teksti i Projektligjit për veprimin klimatik

# KOMENTE PËR LIGJIN PËR VEPRIMIN KLIMATIK

Strukturimi i Ligjit të Veprimit Klimatik është i ndryshëm nga ligjet e tjera në këtë fushë. Kjo vlen veçanërisht për përmendjen dhe thirrjen në dokumentet e ndryshme ndërkombëtare. Në përputhje me këtë, është e përshtatshme që në fillim të kemi të qartë detyrimin nga neni 2 paragrafi 1 alineja 1 duhet të lexoj: - kontribut në përpjekjet në rritje për të forcuar përgjigjen globale ndaj kërcënimit të ndryshimeve klimatike, në përputhje me qëllimin afatgjatë të Marrëveshjes së Parisit, për të mbajtur rritjen e temperaturës globale këtë shekull nën 2°C mbi nivelet para-industriale dhe përpjekjet e vazhdueshme për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1,5°C mbi nivelet para-industriale, si dhe të mbështesë angazhimet për një Evropë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050. Republika e Maqedonisë së Veriut sigurisht që e ka marrë këtë përkushtim, por me këtë do të konfirmohet edhe në ligj.

Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese dhe ka ratifikuar një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me klimën dhe ndryshimet klimatike, prandaj në këtë ligj të gjitha ato duhet të merren parasysh si relevante. Prandaj, neni 2 paragrafi 1 alineja 6 duhet të lexojë - vendosjen e një kornize për politikën, planifikimin dhe masat administrative të nevojshme për të reduktuar emetimet e gazrave serrë nga burimet në një nivel që konsiderohet shkencërisht i nevojshëm, si dhe mirëmbajtjen dhe forcimin e asgjësimeve nga absorbuesit, duke marrë parasysh detyrimet dhe angazhimet e marra në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Rekomandohet në nenin 4 paragrafi 2 alineja 7, ku shpjegohet vënia në dispozicion e raporteve të bëra në përputhje me dispozitat e ligjit, që ato të bëhen publike në ueb faqet zyrtare të autoriteteve. Kjo duhet theksuar, sepse dokumentet nuk janë mjaftueshëm në dispozicion për inspektim publik dhe shpesh ndodh që ato të jenë në dispozicion për inspektim publik vetëm në një tabelë njoftimesh në ambientet e komunave, e cila nuk është as efektive dhe as transparente.

Në tekstin ligjor përdoret termi "*absorbues*", i cili duhet të zëvendësohet me termin "*lavaman karboni*". Është bërë një përkthim i papërshtatshëm i termit "*Carbon sink*" dhe përkthimi më i përshtatshëm është "*lavaman karboni*". Për më tepër, pjesës së përkufizimit të ligjit i mungojnë përkufizimet për termat e mëposhtëm: shkencërisht i nevojshëm, vulnerabiliteti, rezilienca (elasticiteti), vlerësimi konservativ i emetimeve (i instalimit ose operatorit të aviacionit kur është e përshtatshme). Nga ana tjetër, përkufizimi i mospërputhshmërisë nuk duhet të jetë në pjesën me përkufizime, pse në kuptim të këtij ligji mund të ketë mospërputhje të tjera. Duhet të zhvendoset në një nen normativ.

Në nenin 8, paragrafi 4, pika 20, është e përshtatshme të parashikohen tre përfaqësues nga organizatat joqeveritare aktive në fushën e veprimit klimatik, njëri prej të cilëve përfaqësues nga format e organizimit të rinjve. Gjithashtu, paragrafi 6 duhet të shtohet dhe të lexoj: (6) Përbërja e Këshillit përcaktohet me emërimin e sekretarëve shtetëror nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anëtarët e tjerë nga pikat 15), 16), 17), 18) dhe 21) të këtij neni emërohen me kërkesë paraprake të Ministrisë. Përfaqësuesit nga pika 20) i këtij neni zgjidhen në atë mënyrë që Ministria të dërgojë kërkesë për emërim nga Këshilli për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Civil të themeluar në bazë të Vendimit për Themelimin e Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

Në tekstin ligjor përmenden disa organe të ndryshme me funksione dhe lidhje të ndryshme. Disa prej tyre janë tashmë ekzistuese, dhe disa janë të sapoformuara. Kështu, një nen i veçantë i referohet Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm. Nevoja për të përcaktuar punën e këtij këshilli në këtë ligj është e paqartë, sepse puna e tij tashmë është e rregulluar në një Vendim të mëparshëm për themelimin e Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm. Bashkëpunimi i ndërsjellë, komunikimi dhe koordinimi dhe kontributi në veprimin e klimës duhet të përcaktohen në këtë ligj.

Ekziston nevoja për të vendosur qartë marrëdhëniet ndërmjet organit këshillimor shkencor dhe Këshillit Koordinues të Klimës dhe për të parashikuar kritere për përzgjedhjen e anëtarëve.

Është e nevojshme në ligj të shtohet Planit Nacional i Përshtatjes, i cili duhet të jetë pjesë e dokumenteve bazë strategjike dhe planifikuese për veprimin klimatik, sepse është pjesë e detyrimeve ndaj BE-së që ka shteti në sektorin e klimës. Strategjia e BE-së për adaptimin e klimës (COM/2021/82 final) parashikon Planet Nationale të Përshtatjes për t'u marrë me sfidat klimatike. Përmbajtja minimale, procesi i realizimit të Planit Nacional të Përshtatjes, duhet të rregullohet me akt nënligjor që do të rezultojë nga ky ligj.

Rekomandohet të jepen udhëzime më specifike për përcjelljen dhe monitorimin e planit të veprimit, gjegjësisht nenin 11. Në nenin 18 paragrafi (4) të shtohet dhe lexohet: (4) Ministria është e obliguar të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit dhe kur është e nevojshme, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i propozojë amendamente dhe plotësime ose veprime korigjuese. Ministria i paraqet raport Këshillit Koordinues Nacional për zbatimin e Planit të Veprimit çdo 2 vjet. Raporti për zbatimin e Planit të Veprimit është në dispozicion siç përshkruhet në nenin 4 të këtij Ligji.

Në nenin 19 paragrafi (5) është paraparë: Organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit në juridiksionin e të cilëve janë sektorët nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të zhvillojnë dokumente të planifikimit sektorial për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në një proces të gjerë konsultativ dhe duke respektuar dispozitat për pjesëmarrjen e publikut sipas rregulloreve në fushën e mjedisit jetësor. Ligjvënësi duhet të shtojë se: Përmbajtja minimale e dokumenteve të planifikimit sektorial për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përcaktohet nga një rregullore e nxjerrë nga autoriteti përgjegjës për ligjin e veprimit ndaj klimës. Si dhe me një paragraf të ri plotësues për të rregulluar: Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit në juridiksionin e të cilëve janë sektorët nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të zhvillojnë strategji rajonale për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në pajtim me Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Kreu 5-të i ligjit i kushtohet financimit të veprimit klimatik, ai vendos një taksë krejtësisht të re dhe rregullon llogaritjen e saj. Neni 40 përcakton taksën e karbonit, megjithëse gjatë miratimit të ligjit do të shihet më hollësisht se në çfarë forme do të parashikohet: tarifë, kompensim, taksë etj. Ajo që ligjvënësi duhet të parashikojë në nenin 40 është se Qeveria përcakton çmimin dhe metodologjinë për përcaktimin e çmimit për taksën/kompensimin.

Më tej, duke marrë parasysh ndikimin që do të ketë kjo taksë në financimin e veprimit klimatik dhe ndryshimeve në mjedis jetësor në vend, vihet re nevoja për një transparencë më të madhe dhe për rrjedhojë neni 41 duhet të parashikojë edhe pjesëmarrjen e një përfaqësuesi nga sektori i organizatave civile në Komisionin për ndarjen e mjeteve nga veprimi për klimën i themeluar nga ministri. Gjithashtu, paragrafi 6, përveç publikimit të konkursit publik për ndarjen e mjeteve në dy gazeta ditore, duhet të plotësohet edhe me publikim në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë, me afat aplikimi prej 30 ditësh.

Së fundi, dispozitat që kanë të bëjnë me Lejen për emetimin e gazrave serrë (neni 44-neni 51) duhet të rregullohen plotësisht në përputhje me qëllimin e ligjit - të mundësojë veprimin klimatik dhe reduktimin e emetimeve, duke parashikuar një sistem organizimi dhe/ose tregtimi të emetimeve të serrave dhe aplikimi i vonuar në faza. Në fazën e parë të sigurohet ndjekja e planit të monitorimit dhe më pas futja në faza e sistemit të kufizimit të emetimeve dhe tregtimit. Si dhe të shkruhen dispozitat kalimtare për fillimin e zbatimit të këtyre dispozitave.

# REKOMANDIME

- › Të përcaktohen përgjegjësitë institucionale në aktivitetet për klimën me personelin e nevojshëm, të kualifikuar dhe për aq sa është e mundur, një strukturë të veçantë për veprimin klimatik, qoftë sektor apo departament.
- › Të sigurohet një mandat i qartë dhe përshkrim gjithëpërfshirës i qëndrueshëm të detyrave dhe përgjegjësi të secilës prej këtyre strukturave për veprimin klimatik, duke shmangur mbivendosjet dhe konfliktet e kompetencave me strukturat e tjera brenda të njëjtit institucion ose me institucione të tjera.
- › Të sigurohet që secila prej këtyre strukturave të veprimit klimatik të jetë e pajisur me personel dhe të pajisur me burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe teknike, duke mbuluar të gjitha subjektet përkatëse që përfshihen në kompetencat dhe funksionet e tyre (politika, rregullore, monitorimi, raportimi, ligji dhe financa).
- › T'u sigurohen institucioneve përgjegjësi në aktivitetet klimatike me mbështetje ligjore dhe financiare.
- › Kur detyrat në veprimin klimatik ndahen brenda një institucioni specifik, të sigurohet që ekzistojnë mekanizmat e komunikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit.
- › Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për përgatitjen në kohë të dokumenteve nacionale të ndryshimeve klimatike.
- › Të caktohet qartë se kujt i raporton Republika e Maqedonisë së Veriut në lidhje me veprimin klimatik, duke qenë se nuk është anëtare e BE-së.
- › Të bëhet financimi i klimës dhe të tregohet qartë se ku do të vendosen paratë nga taksa e karbonit në buxhet dhe të zbatohet në përputhje me rrethanat.
- › Të ruhet përcaktimi i qëllimit të parave të grumbulluara nga taksa e karbonit si në projektligj, me qëllim përshtatjen proaktive ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit.

# LITERATURA E PËRDORUR

- › <https://climate.nasa.gov/global-warming-vs-climate-change/#:~:text=Global%20warming%20is%20the%20long,gas%20levels%20in%20Earth's%20atmosphere>
- › Raport për vlerësimin e ndikimit të rregullores - Ligji për veprimin klimatik, i publikuar në Regjistrin e unifikuar nacional të rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&sub-item=view\\_reg\\_detail&itemid=77486](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&sub-item=view_reg_detail&itemid=77486)
- › Raporti përfundimtar i auditimit të performancës "Masat dhe politikat e marra nga RMV-ja/autoritetet kompetente për të zbutur ndryshimet klimatike", maj 2022 [https://dzm.mk/sites/default/files/2022-07/68\\_RU\\_Prezeni\\_merki\\_politiki\\_ublazuvanje\\_klimatski\\_promeni\\_KOMPLET\\_2022.pdf](https://dzm.mk/sites/default/files/2022-07/68_RU_Prezeni_merki_politiki_ublazuvanje_klimatski_promeni_KOMPLET_2022.pdf)
- › [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&sub-item=view\\_reg\\_detail&itemid=77486](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&sub-item=view_reg_detail&itemid=77486)
- › Draft-teksti i Projektligjit për Veprim Klimatik
- › Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga perspektiva e ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM, Shkup 2023

